



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.32, datë 23.09.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.02.2023 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 23.09.2024 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës"

Vëren se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës me shkresën nr. 4410 prot. datë 29.08.2024 me lëndë: "Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit teknik", plotësimet me e-mail. datë 06.09.2024 me lëndë: "Kthim përgjigje për ndryshimin e të dhënave në licencën e SHRUKD sh.a.", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar;
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) pranoi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës për rinovim licence për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknik.
3. **KKRR** ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës me vendimin nr. 6, datë 22.02.2023 "Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës, me një afat 4

vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi i ri teknik i shoqërisë Z. Olsen Kavalli, i cili zëvendëson ish drejtuesin teknik z. Gerald Dautaj, ka diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike, me profil “Profesional - Energjitikë” në vitin 2011, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjithashtu, disponon diplomë Master Shkencor në “Politika dhe Administrim”, viti 2019, Profili Administrim Publik, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe Master i shkencave në Teknologji Informacioni, vitin 2013, në universitetin jo publik Kristal.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknik ka marrë në konsideratë kërkesat e ligjit nr. 8102, e VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit referuar eksperiencës mbi 10-vjeçare pranë kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 b) e vendimit të KKRR nr. 6, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës ” ndryshojnë si më poshtë:

b) Drejtues Teknik z. Olsen Kavalli

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

EDIOLA BRAHA